



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 04/144 Nr. i faq./Br.str./No.pg 88

Data/Datum/Date 29.05.2026

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 17, nenit 34 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, nenit 7 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 178/21 të datës 29.03.2021, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 13, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.19 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.05.2026 miraton këtë:

V E N D I M

Për emërimin e komisionit të ankesave për procesin e zgjedhjes së këshillave lokale

1. Me këtë vendim emërohet komisioni për shqyrtimin e ankesave për procesin e zgjedhjes së këshillave lokale në fshtara, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e komunës së Rahovecit.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 3 (tre) anëtarëve të cilat zgjedhën nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës, si në vijim:
 - 2.1. **Florida Bajraktari**, anëtar Kuvendi i Komunës nga subjekti politik AAK;
 - 2.2. **Hazbije Shala**, anëtar Kuvendi i Komunës nga subjekti politik LDK;
 - 2.3. **Zana Qanta**, anëtar Kuvendi i Komunës nga subjekti politik LVV;
3. Kryesuesi i komisionit zgjedhet me konsensus të brendshëm të anëtarëve të komisionit.
4. Komisioni i ankesave ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga palët në procesin zgjedhor për zgjedhjen e këshillave lokal dhe atë brenda afatit prej 15 ditëve nga data e parashtrimit të ankesës, t'u kthejë përgjigje me shkrim atyre që kanë adresuar ankesën.
5. Komisioni i ankesave ka për detyrë që të mbajë procesverbal për çdo takim që e mbanë dhe t'i raportojë Kuvendit të Komunës.
6. Obligohet komisioni që punët t'i kryej duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane si dhe Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 178/21, të datës: 29.03.2021.

7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Anëtarëve të komisionit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01 Nr.144/26

Datë:29.05.2026



Fatmir Iska

Kryesues i Kuvendit